



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 22, datë 28.12.2022

PËR

RISHIKIMIN E KUSHTEVE GJATË NDËRTIMIT DHE NDRYSHIM TË SUBJEKTIT
ZHVILLUES NË VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT NR. 12,
DATË 07.06.2016 PËR OBJEKTIN: “KOMPLEKS REZIDENCIAL DHE QENDËR PËR
TË MOSHUARIT, TIRANA CIELO”, ME VENDNDODHJE NË MJULL-BATHORE,
BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 13 dhe 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqëria “Gjoka Konstruksion” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve gjatë ndërtimit për objektin: “Kompleks rezidencial dhe qendër për të moshuarit, Tirana Cielo”, me vendndodhje në Mjull-Bathore, Bashkia Tiranë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 12, datë 07.06.2016.
2. Miratimin e ndryshimit të subjektit zhvillues për objektin: “Kompleks rezidencial dhe qendër për të moshuarit, Tirana Cielo”, me vendndodhje në Mjull-Bathore, Bashkia Tiranë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 12, datë 07.06.2016, nga “Urban Garden” sh.p.k, në “Gjoka Konstruksion” sh.p.k.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 12, datë 07.06.2016, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA




MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INERASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 29/12 / 2023